



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
ASAMBLEJA

Nr. 419 prot.

Tiranë, më 30.11.2016

V E N D I M

Nr. 7 datë 30.11.2016

Asambleja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, sipas rendit të ditës të miratuar më parë (bashkëngjitur), në mbështetje të Ligjit dhe të Statutit të ASH-së, në mbledhjen e saj të datës 30 nëntor 2016, ora 10.00;

V E N D O S I:

1. Për reformën në kërkimin shkencor nga të dy Seksionet e ASH do të përgatitet një material i përbashkët mbështetur qëndrimit unanimit dhe në emër të Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Pas draftimit përfundimtar, materiali si qëndrim i Asamblesë së ASH-së për reformën institucionale të kërkimit shkencor do të dërgohet zyrtarisht nga Kryesia e ASH-së pranë grupit të punës të ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
2. Anëtarët, përfaqësues të asamblesë së ASH-së në jurinë e çmimeve shkencore kombëtare vjetore që jep Akademia e Shkencave, janë:
-*Aurela Anastasi, anëtare*
-*Floran Vila, anëtar*
3. Hapjen e 1 (një) vendi të lirë "Për anëtar të përhershëm".
4. Hapjen e 2 (dy) vendeve të lira "Për anëtarë të asociuar", përkatësisht:
-1 (një) vend i lirë në fushën e shkencave shoqërore albanologjike "Antropologji".
-1 (një) vend i lirë në fushën e shkencave natyrore teknike "Shkencat e jetës".
5. Ngarkohen Seksionet shkencore që në bashkëpunim, të përgatisin Krioteret dhe Thirrjen Publike për pjesmarrje konform ligjit dhe Statutit të ASH-së, në zbatim të pikave 3 dhe 4 të këtij Vendimi, brenda datës 10 dhjetor 2016 dhe ti paraqesin ato në Kryesi për miratim.
6. Ngarkohet Sekretari Shkencor për ndjekjen e zbatimit të këtij Vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

MUZAFER KORKUTI

